



# USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 31 (827678)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 7 gusht 2020

## Gjeneralmajor Begaj u betua para presidentit të Republikës Ilir Meta



### Gjeneralmajor Bajram Begaj, merr detyrën si shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA

Shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, dekretuar me 29 korrik nga Presidenti Ilir Meta, njëkohsisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, më 30 korrik 2020 mori detyrën në një ceremoni ushtarake, ku flamurin kombëtar ia dorëzoi

ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka. Më herët gjeneralmajor Begaj u betua para presidentit të Republikës Ilir Meta dhe me dorën mbi Kushtetutë. Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka falënderoi shefin në largim të Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, për të cilin tha se do... >>> faqe 3

## Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako

### Situata e zjarreve, shumica e qëllimshme, bashkitë të marrin përgjegjësitë e tyre



>>> faqe 4

# Diplomohen oficerët e rinj të FA Akademia e Forcave të Armatosura hap dyert për studimet bachelor

Tridhjetë vajza dhe djem përfunduan kursin 1-vjeçar të oficerit të ri në Forcat e Armatosura >>> faqe 2



## 200 djem e vajza në e luftë me zjarret

### FA të angazhuara kundër zjarreve në pyje e kullota

"Forcat e Armatosura janë angazhuar maksimalisht në përballimin e situatës së krijuar në vend nga zjarret në pyje e kullota, me qëllim garantimin e sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjen e pasurisë kombëtare. Por kjo betejë, nuk është vetëm e Forcave të Armatosura", deklaroi ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka. "Zjarret masive që kanë goditur pyjet e kullotat ditët e fundit kanë marrë përgjigjen tonë të menjëhershme. 200 djem..."



>>> faqe 5

## Forca Ajrore

### Helikopteri "Coungar" me mision për shuarjen e zjarrit në Rubik

Në datën 29 korrik 2020, në dispozicion të Emergjencave Civile nga Baza Ajrore Farkë, u nis helikopteri Cougar për në pyjet e Molongut, në afërsi të fshatrave Katund i Vjetër-Rrasfik në zonën e Rubikut. Helikopteri Cougar i pajisur me kovën e posaçme për shuarjen e zjarrit ka përfunduar me sukses operacionin e shuarjes së zjarrit duke hedhur... >>> faqe 6



### Forca Tokësore e NATO-s

#### Gjenerallejtënant

Cloutier mori detyrën nga

Gjenerallejtënant Thomson >>> faqe 9

### QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

Starton rekrutimi, 8 (tetë) të drejta studimi në Akademitë Ushtarake të Turqisë >>> faqe 4

### HISTORI

Në kuadrin e 100 vjetorit, lufta e Dibrës 1920

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ >>> faqe 15



## Diplomohen oficerët e rinj të FA

# Akademia e Forcave të Armatosura hap dyert për studimet bachelor

*Tridhjetë vajza dhe djem përfunduan kursin 1-vjeçar të oficerit të ri në Forcat e Armatosura*

Zhvillohet ceremonia e përfundimit të kursin 1-vjeçar të oficerit të ri në Forcat e Armatosura. Në ceremoninë e diplomimit të tyre ditën e hënë, më 3 gusht 2020, mori pjesë edhe ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila njoftoi rihapjen e Akademisë së Forcave të Armatosura për maturantët shqiptarë për ciklin akademik 2020-2023.

Ministrja Xhaçka përmendi investimet e viteve të fundit në modernizimin e FA, por i kushtoi më shumë rëndësi investimit në arsimimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore. “Sot, padyshim ka ende shumë nevojë e shumë punë. Por FA janë në një situatë komplet tjetër. Qoftë përsa i përket pajisjeve. Qoftë përsa i përket armatimeve. Qoftë përsa i përket trajnimit, organizimit e trajtimit. Sot, kemi hedhur hapa konkretë drejt ndërtimit të një ushtrie profesioniste, të standardeve të NATO. Dhe se çfarë progresi është bërë, falë punës së të gjithë ushtarakëve e profesionistëve të përkushtuar, mbështetjes së aleatëve e padyshim edhe të qeverisë, kjo duket fare mirë tek performanca e njësisve tona që shërbejnë në misionet e NATO. Por edhe pse si ministre jam e lumtur sa herë FA arrijmë t’ju vëmë në dispozicion armatime e sisteme armatimesh të reja, duke filluar nga mjetet e deri tek helikopterët, nga radarët e deri tek investimi i jashtëzakonshëm që do të bëhet në bazën e Kuçovës, asgjë nuk më ka gëzuar më shumë, asgjë nuk më ka bërë të ndihem që puna jonë po bën një ndryshim real, sesa investimi tek dija, tek arsimimi i ushtarakëve.”

Në prag të përzgjedhjes nga maturantët të universiteteve ku ata duan të studiojnë, ministrja Xhaçka u bëri thirrje atyre të marrin në konsideratë studimet bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura. “Sot, ushtria fillon e kthehet në një profesion të mirëfilltë, që ofron mundësi avancimi e karriere për çdo djalë e vajzë që ka dëshirën për t’i shërbyer vendit, aftësinë për të përballuar sfidën akademike, por edhe atë fizike e të ter-



renit si dhe disiplinën që është pjesë e karakterit të çdo ushtaraku. Prandaj ju bëj thirrje të gjithë maturantëve që besojnë se i plotësojnë këto kriteret, që të aplikojnë për ciklin akademik 2020 – 2023. Dhe i garantoj që do të gjejnë

këtu rrugë e mundësi jo thjesht shumë më të mëdha seç i kanë menduar, por edhe shumë më konkrete sesa ato që ofrojnë shumë e shumë degë të tjera të institucioneve të arsimit të lartë.”

Akademia e Forcave të Armatosura

e shndërruar sivjet në një institucion të mirëfilltë të arsimit të lartë, ofron 60 kuota për maturantët për programin bachelor në Shkenca Ushtarake. Akademia ofron kushte jashtëzakonisht të favorshme për çdo maturant. Që

nga akomodimi dhe ushqimi falas për të gjithë periudhën e studimit, tarifë studimi 0 lekë në vit, pagesë mujore ndihmëse për të gjithë periudhën e studimit dhe punësim të sigurt pas përfundimit të studimeve.

STAFI

**DED KOLA**  
Shef i Sektorit të  
Botimeve & Kryeredaktor

**Gazetarë:**  
Mimoza **GOLIKJA**

**Gazetarë:**  
Saimir **ALIJA**

**Graphic Designer:**  
Afërdita **HYSAJ**

**ADRESA:**  
Rruga e Dibrës/  
Garnizoni “Skënderbej”

## Gjeneralmajor Begaj u betua para presidentit të Republikës Ilir Meta

## Gjeneralmajor Bajram Begaj, merr detyrën si shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA

*Ministrja Xhaçka: "Gjeneralmajor Bajram Begaj është padyshim një nga ushtarakët më të përgatitur e më me vlerë që kanë sot FA"*

Shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, dekretuar me 29 korrik nga Presidenti Ilir Meta, njëkosisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, më 30 korrik 2020 mori detyrën në një ceremoni ushtarake, ku flamurin kombëtar ia dorëzoi ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka. Më herët gjeneralmajor Begaj u betua para presidentit të Republikës Ilir Meta dhe me dorën mbi Kushtetutë.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka falënderoi shefin në largim të Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, për të cilin tha se do të vijojë të jetë pjesë e FA dhe për të dhënë kontributin e tij.

Ministrja Xhaçka e cilësoi gjeneralmajor Bajram Begajn si një nga ushtarakët më të kualifikuar, mëse i përshtatshëm për sfidat që po kalojnë jo vetëm Forcat e Armatosura, por edhe shoqëria në tërësi.

"Gjeneralmajor Bajram Begaj është padyshim një nga ushtarakët më të përgatitur e më me vlerë që kanë sot FA. Unë pres, të gjithë ne presim, që drejtuesi i ri i Shtabit të çojë përpara procesin e modernizimit e profesionalizimit që tashmë ka fituar një momentum vërtet pozitiv. FA është sot një forcë që kontribuon me kontingjentet e saj krahas për krahas aleatëve në misionet të vështira e të rrezikshme, ku efektivet tanë kanë marrë vlerësimet më të larta. FA është sot një forcë që po përthith me ritme mbresëlënëse jo vetëm pajisje e sisteme armatimi shumë herë më të avancuara sesa ato që kemi pasur në dispozicion deri pak vite më parë, por që po investon si kurrë më parë tek burimet e saj njerëzore. Gjeneralmajor Begaj zotëron kualifikime krejt të posaçme që e bëjnë atë një kandidat të shkëlqyer për kohën që kalojmë. Ai është jo vetëm një ushtarak karriere, me një karrierë jashtëzakonisht të pasur ku ka spikatur me përgatitjen, talentin dhe idetë e tij. Por ai është dhe një mjek, një nga mjekët më të njohur në fakt në Shqipëri. Pra, ai është një ushtarak i trajnuar e kualifikuar për të kuptuar jo vetëm sfidat tradicionale të sigurisë, por edhe sfidat e jashtëzakonshme që na vijnë nga armiq të padukshëm por ndoshta akoma më të rrezikshëm." - u shpreh zonja ministre.

Në fjalën e tij, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Bajram Begaj tha se ishte mirënjohës për besimin e Presidentit Meta, Kryeministrit Rama dhe ministres së Mbrojtjes, Olta Xhaçka.

"Akademia e Forcave tona të Armatosura është një histori suksesi që tregon se pavarësisht vështirësive



dhe problematikave që mund të hasen nëse ka vullnet dëshirë dhe profesionalizëm rezultatet mund të arrihen. Transformimi i Akademisë Ushtarake dhe akreditimi institucional si i vetmi institucion i lartë i arsimit publik për mbrojtjen dhe

sigurinë kombëtare do sjellë ndryshim rrënjësor në rrjedhën e arsimit profesional ushtarak dhe përgatitjen cilësore të ushtarakëve. Misioni i FA është ruajtja e paqes dhe sigurisë që tashmë e realizojmë si anëtarë të NATO-s, ku vendi ynë dhe Forcat

e Armatosura po dëshmojnë se dinë të solidarë me aleancën, të mbajnë barrën e detyrimeve që u takon por dhe të kontribuojnë në sigurinë kolektive për paqen globale dhe rajonale", u shpreh ai.

Gjeneral brigade Bardhyl

Kollçaku, i cili dorëzoi detyrën falënderoi bashkëpunëtorët e dhe përmendi arritjet e Forcave të Armatosura gjatë drejtimit të tij, pa harruar të përmendë çastet e vështira, që nga përmbytjet, te tërmetet dhe së fundmi gjatë pandemisë.

Shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj shërbente si komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjatë drejtimit të së cilës e shndërroi Akademinë e FA në një institucion të mirëfillt të arsimit të lartë dhe në të vetmin në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Gjeneralmajor Bajram Begaj, ka lindur në vitin 1967 në Rrogzhi. Ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë në degën Mjekësi e Përgjithshme në vitin 1989 dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin "Mjekësi" në vitin 1998.

SHEFI I RI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FA-VE, GJENERAL MAJOR BAJRAM BEGAJ

## Gjeneralmajor Begaj betohet para presidentit të Republikës Ilir Meta

*"Betohem se do t'i bindem Kushtetutës e ligjeve, do t'i shërbej me ndershmëri vendit tim dhe do të mbroj interesat e Republikës së Shqipërisë"*

Shefi i ri i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneral Major Prof. Asoc. Bajram Rushit Begaj u betua më 30 korrik 2020, para Presidentit të Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta, njëkohësisht Komandant i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Pas ekzekutimit të himnit kombëtar dhe leximit të dekretit të emërimit, Gjeneral Major Begaj duke vënë dorën mbi Kushtetutë, u zotua para Presidentit Meta se:

"Betohem se do t'i bindem Kushtetutës e ligjeve, do t'i shërbej me ndershmëri vendit tim dhe do të mbroj interesat e Republikës së Shqipërisë."

Duke i dorëzuar dekretin e emërimit, Kryetari i Shtetit i uroi Shefit të Shtabit të Përgjithshëm punë të mbarë dhe suksese në detyrën tepër të rëndësishme në drejtimin e Forcave të Armatosura shqiptare. Presidenti Meta theksoi se edukimi dhe specializimi i Gjeneral Ma-



jor Begaj në fushën e mjekësisë është një vlerë e shtuar që do ta ndihmojë atë në ushtrimin me përgjegjshmëri të lartë të kësaj detyre, veçanërisht në kushtet e përballimit të sfidave të kohës për Forcat tona të Armatosura, si pjesë e NATO. Në ceremoninë e betimit ishin të pranishëm edhe ministrja e Mbrojtjes zonja Olta Xhaçka,

Zëvendëseshfja e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, Komandanti i Forcës Tokësore Gjeneral Brigade Albert Mullai, si dhe Komandanti i Komandës Mbështetëse të FA-ve, Gjeneral Brigade Ndriçim Sallaku.

## QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

# Starton rekrutimi, 8 (tetë) të drejta studimi në Akademitë Ushtarake të Turqisë

*Shkolla e Lartë e Forcës Tokësore, 4 (katër) kuota. Shkolla e Lartë e Forcës Detare, 1 (një) kuota. Shkolla e Lartë e Forcës Ajrore, 1 (një) kuota. Fakulteti Mjekësisë Gulhane, 2 (dy) kuota. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri në 17 Gusht 2020*

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Turqisë, 8 (tetë) të drejta studimi si më poshtë vijon: Shkolla e Lartë e Forcës Tokësore, 4 (katër) kuota. Shkolla e Lartë e Forcës Detare, 1 (një) kuota. Shkolla e Lartë e Forcës Ajrore, 1 (një) kuota. Fakulteti Mjekësisë Gulhane, 2 (dy) kuota. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 17 Gusht 2020.

## Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare. Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ose në raste të veçanta të jetë në vitin e fundit të studimeve parauniversitare. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të mos jetë i martuar, i fejuar, i ve ose të mos bashkëjetojë. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen, të mos ketë tatuazhe ne pjesët e trupit, të mos jetë dystaban, të mos ketë në trup plagë apo shenja djegie, të jetë me flokë dhe të mos ketë sëmundje të lëkurës. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike. Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve pranë Akademive Ushtarake në Turqi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare mbi 8 (tetë), mesatarja e notave të të gjitha viteve të gjimnazit për lëndët Matematik, Fizik dhe Kimi të jetë mbi 8 (tetë) dhe notat e maturës shtetërore të jenë mbi 8 (tetë). Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: a. Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë; b. Kanë fituar më parë statusin



e studentit ushtarak; c. Kanë qenë përfundimin e arsimit përkatës së kontingjentit të Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

## Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve pranë Akademive Ushtarake të Turqisë. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton

përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografii për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë

shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore të vendbanimit, ku deklarohet se kandidati është i aftë për punë. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B,



Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Librezën e vaksinave. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

**Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 5 ditëve:**

Dëshmi penaliteti. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi. Vërtetim nga përmbartimi. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjekë-Ligjor (KML) i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

## Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj: 18.08.2020 Testi Fizik: 18.08.2020 Testi Intelektual: 19.08.2020 Testi Psikologjik: 19.08.2020

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjellë përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

200 DJEM E VAJZA NË E LUFTË ME ZJARRET

## FA të angazhuara kundër zjarreve në pyje e kullota

“Forcat e Armatosura janë angazhuar maksimalisht në përbalimin e situatës së krijuar në vend nga zjarret në pyje e kullota, me qëllim garantimin e sigurisë së qytetarëve dhe mbrojtjen e pasurisë kombëtare. Por kjo betejë, nuk është vetëm e Forcave të Armatosura”, deklaroi ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka.

“Zjarret masive që kanë goditur pyjet e kullotat ditët e fundit kanë marrë përgjigjen tonë të menjëhershme. 200 djem e vajza të Forcës së Armatosur të angazhuar në Seman, Shkodër, Lezhë etj po japin maksimumin për të garantuar sigurinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e pasurisë

kombëtare”, thekson Xhaçka.

“Dhe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë me çdo mundësi, çdo burim, aset e mjet që kemi. Por kjo nuk mund të jetë vetëm beteja e FA. Kjo duhet të jetë beteja e të gjithëve ne, e çdo qytetari, e mbi të gjitha e çdo strukture të pushtetit vendor që ligji e ngarkon me përgjegjësi për të siguruar jetën dhe pronën e qytetarëve shqiptarë”, nënvizon Xhaçka. Nga muaji janar deri në korrik janë evidentuar 329 vatra zjarri, ku vetëm për muajin korrik janë evidentuar 168 vatra zjarri. Në total në të gjithë Shqipërinë janë djegur 598 hektarë, duke përfshirë dhe 2419 rrënjë ullishte dhe 217 rrënjë pemëtarie.



DREJTORI I AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE, HAKI ÇAKO

# Situata e zjarreve, Shumica e qëllimshme, bashkitë të marrin përgjegjësitë e tyre

*Në total ne gjithë Shqipërinë janë djegur 598 hektarë duke përfshirë dhe 2419 rrënjë ullishte dhe 217 rrënjë pemëtarie*

Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Haki Çako doli në një deklaratë për mediat pas situatës së krijuar ditët e fundit nga zjarret në vendin tonë.

Pasi bëri një përmbledhje të numrit të zjarreve dhe sipërfaqeve të djegura, zoti Çako theksoi se shumica e zjarreve në vend kanë qenë të qëllimshme. Ai konfirmoi gatishmërinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe e vuri theksin te përgjegjësitë që duhet të marrë pushteti vendor për të përbaluar i pari emergjencat civile.

Deklarata e plotë e drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile:

Ardhja e stinës së verës u shoqërua me rritje të mëdha të temperaturave duke shtuar së tepërmi mundësinë e rënies së zjarreve në pyje, sipërfaqe me shkurre, kullota etj.

Shkaqet e rënies së zjarreve natyrisht janë temperaturat e larta, por nuk ka munguar neglizhenca, pakujdesia e banorëve të zonës dhe në shumë raste ka qenë zjarrvëniet e qëllimshme, për të cilët Policia e Shtetit po heton dhe, gjej rastin ta inkurajoj për intensifikimin e punës për gjetjen dhe kapjen e autorëve të vënies së zjarreve.

Nga muaji janar deri në korrik janë evidentuar 329 vatra zjarri, ku vetëm për muajin korrik janë evidentuar 168 vatra zjarri.

Sipas raportimeve të bëra nga bashkitë dhe prefekturat në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) bashkitë më të prekura janë: Shkodra, Fieri, Vlora, Durrësi, Gjirokastra, Lezha, Dibra, Korça, Berati, Kukësi, Tirana, dhe Elbasani. Në total ne gjithë Shqipërinë janë djegur 598 hektarë duke përfshirë dhe 2419 rrënjë ullishte dhe 217 rrënjë pemëtarie. Gjatë gjithë kësaj periudhe AKMC ka qenë dhe do të vijojë të jetë në gatishmëri të plotë për të dhënë asistencën e saj si autoriteti qendror koordinues, kontrollues dhe mbikëqyrës në fushën e Mbrojtjes Civile dhe të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.

AKMC gjatë gjithë kësaj periudhe përveç koordinimit dhe menaxhimit të situatës së krijuar në mënyrë të pandërprerë ka kryer dhe rolin e kontrolluesit dhe monitoruesit të të gjitha strukturave të angazhuara në përbalimin e kësaj situatë.

Ndërkohë që disa bashki janë angazhuar maksimalisht në përbalimin e zjarreve si me mjete ashtu dhe me njerëz disa prej tyre ende sot nuk po përdorin tërësinë e aseteve të deklaruara për çështje të mbrojtjes civile.



Duhet të jetë e qartë nga të gjithë se Mbrojtja Civile nuk është thjesht një kompetencë e shtuar për to, por një detyrim dhe një përgjegjësi primare e tyre, për të cilat duhet të

jenë të përgatitura me njerëz, mjete, strategji vendore, plane veprimi dhe buxhetim përkatës.

Në çdo rast fatkeqësie, janë vetë bashkitë ato të cilat mbajnë rolin dhe

peshën kryesore për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, ndërkohë që angazhimi i strukturave qendrore operacionale siç janë FA apo Policia e shtetit sipas ligjit vjen vetëm pas ezaurimit të resurseve në nivel vendor.

AKMC dhe Ministria e Mbrojtjes janë në kontakt të vazhdueshëm me pushtetin vendor, dhe janë duke ndjekur në kohë reale situatën në çdo vatrë zjarri. Forcat e Armatosura janë në gatishmëri të plotë për t’ju përgjigjur çdo përkeqësimi situatë siç kundër e kanë bërë deri tani përmes ndërhyrjeve nga ajri. Sipas ligjit të ri “Për Mbrojtjen Civile”, Forcat e Armatosura angazhohen në raste emergjencash duke asistuar të gjithë ato bashki të cilat kanë përmbushur detyrimet tyre ligjore për angazhimin e kapaciteteve

dhe respektimin e ligjit për parandalimin dhe përbalimin e zjarrvënieteve. AKMC ka konstatuar se disa bashki rendin të kërkojnë ndërhyrjen e FA pa ezauruar më parë kapacitetet e tyre, veprim i cili sjell një faturë financiare disa herë më të lartë se sa ajo që ligji parashikon për pushtetin vendor në rastin e emergjencave civile.

Në bazë të ligjit të ri, AKMC si strukturë koordinuese ju rikujton bashkive që nuk zbatojnë ligjin se do të përballesh me penalitete për çdo rast, kur nuk respektojnë dispozitat ligjore për përbalimin e emergjencave civile.

Së fundmi do të dëshiroja t’u bëja thirrje të gjitha strukturave të qeverisjes vendore që të bashkëpunojnë ngushtë me Policinë e Shtetit me qëllim intensifikimin e përpjekjeve për gjetjen e autorëve të zjarreve të qëllimshme dhe vënien e tyre para përgjegjësisë.

Rreth 200 efektivë të Forcave të Armatosura u kanë ardhur në ndihmë forcave zjarrfikëse në disa bashki të vendit, ku janë evidentuar disa vatra zjarri. Diten e martë 10 vatra ishin aktive, por nën monitorim dhe nuk paraqesin asnjë rrezik për qytetarët. Ndërkohë që 3 vatra janë shuar në qarkun e Dibrës.

Qendra Kombëtare Operacionale e Mbrojtjes Civile bën me dije se në Lezhë ishin aktive 4 vatra zjarri, në njësinë administrative Shëngjin, zona Rëra e hedhur-Maja e Zezë dhe po punohet për izolimin e tyre. Zjarri në malin e Kakarriqit është izoluar pothuajse totalisht.

## Dhjetë vatra zjarri aktive, por nën monitorim



Ndërsa në Rubik, në fshatin Katund i Vjetër, vatra kishte intensitet të ulët dhe është nën monitorim. Në Elbasan ka patur një vatrë zjarri në Gramsh në fshatin Siman. Policia ka nisur hetimin për shkaqet e zjarrit. Në Fier nga 3 vatra, 2 tashmë janë lokalizuar dhe janë drejt përmirësimit. Situata është nën kontroll edhe në fshatin Hekal, Mallkastër, ku u raportua për zjarr në sipërfaqe me shkurre ullishte dhe pemëtarie. Vështirësi ka paraqitur terreni në njësinë administrative Terpan në pyllin e Ballollit në Berat, por zjarri nuk përbën rrezik për komunitetin, pasi ndodhet larg zonave të banuara.

**N**jë helikopter i Forcave Ajrore Shqiptare ka bërë më 30 korrik 2020, ulje të detyruar në një nga zonat e Toscanas në Itali. Mediat Italiane shkruajnë se mjeti fluturues ishte nisur nga Franca drejt Shqipërisë por në një moment ka pësuar avari duke bërë zbritje urgjente në Casentino. Ngjarja është rregjistruar mëngjesin e kësaj të enjte. Helikopteri kishte në bord katër anëtarë.

Mësohet se mjeti ajror pësoi nxeheje të pjesëve motorrike. Fillimisht helikopteri u pa nga një banor i komunës Poppi, i cili lajmëroi edhe karabinierët. Këta të fundit pas konstatimeve të para thanë se nga ky rast mund të kishte ndodhur edhe një tragjedi.

“Shkathësia dhe gatishmëria e pilotit shmangën më të keqen. Nuk ka dëmtime në mesin e anëtarëve të ekuipazhit, dhe as në mesin e popullatës, nuk ka dëmtime në strukturat”, tha policia italiane.

“Është një imazh që do të mbetet i gdhendur në kujtesën e shumë njerëzve. Një fushë, panorama e shkëlqyeshme e Casentino dhe më pas një helikopter i Forcave Ajrore Shqiptare. Po pse avioni u gjend atje? Këtë mëngjes, pasi po kthehej në shtëpi nga Franca, helikopteri pati një avari dhe duhej të bënte një ulje emergjente në fshatin Poppi. Menjëherë autoritet vendase shkuan për ndihmë. Katër anëtarët e ekuipazhit janë mirë, por procedurat për të riparuar dështimin kanë qenë të gjata dhe komplekse”, shkruan italianian areznotizie. it. Rreth orës 11, Karabinierët e Bibbiena të udhëhequr nga kapiteni Giuseppe Barbato ndërhyjnë në një tokë të Cerromondo, komuna e Poppi. Një qytetar sapo kishte raportuar uljen e një helikopteri të huaj.

Ata identifikuan ekuipazhin e një helikopteri ushtarak shqiptar me dy oficerë në bord, përfshirë pilotin dhe komandantin. Largimi nga Franca, ku avioni ishte për shkak të mirëmbajtjes, pasi ishte ndalur në Itali, po vazhdonin për në Shqipëri. Por befas mbinxeheja e njerit prej përbërësve e bëri të domosdoshëm aktivizimin e procedurave të urgjencës, duke detyruar uljen. Kishte momente shumë delikate për të menaxhuar. “Shkathësia dhe gatishmëria e pilotit shmangi më të keqen. Nuk ka dëmtime në mesin e anëtarëve të ekuipazhit, dhe as dëme në strukturat,” shpjegojnë Karabinierët e Bibbiena. Teknikët e specializuar do të ndërhyjnë për të vlerësuar masën e dëmit. Marrëveshjet janë duke u zhvilluar midis autoriteteve shqiptare dhe italiane për rikuperimin e avionit, ndërkohë ai vendoset i sigurt dhe i monitoruar për të mos lejuar që dikush t’i afrohet.



## FORCA AJRORE SHQIPTARE-SHMANGET TRAGJEDIA

# Në kthim nga Franca, helikopteri bën ulje të detyruar në Itali

*Nuk ka dëmtime në mesin e anëtarëve të ekuipazhit, dhe as dëme në strukturat,” shpjegojnë Karabinierët e Bibbiena*



## FORCA AJRORE

# Helikopteri “Coungar” me mision për shuarjen e zjarrit në Rubik

**N**ë datën 29 korrik 2020, në dispozicion të Emergjencave Civile nga Baza Ajrore Farkë, u nis helikopteri Cougar për në pyjet e Molongut, në afërsi të fshatrave Katund i Vjetër-Rrasfik në zonën e Rubikut. Helikopteri Cougar i pajisur me kovën e posaçme për shuarjen e zjarrit ka përfunduar me sukses operacionin e shuarjes së zjarrit duke hedhur rreth 40.000 litra ujë. Ky operacion ka zgjatur 2 orë e 50 minuta. Struktura e Forcës Ajrore dhe kryesisht Baza Ajrore Farkë do të vazhdojnë të qëndrojnë në gatishmëri për t’u përgjigjur në të gjitha rastet kur do kërkohej ndihma dhe ndërhyrja e tyre.



**Q**endra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020 -2021, për 60 (gjashtëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimi universitar i përafrohet si vijon: Personel (Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti Juridik), Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Pilot (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatik dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera) Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 17 korrik 2020. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është shtyer deri në 28 gusht 2020.

#### Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të ketë figurë të pastër morale; të mos ketë probleme me deportimin; të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (01 Gusht 2021). Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (01 Gusht 2021); të kenë gjatësinë trupore mbi 170 për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse, të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të jenë në zotërim të diplomës së arsimit të lartë, (minimumi bechelor) brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jomë pak se 6 (gjashtë); të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i



## Akademia e Forcave të Armatosura

# Viti akademik 2020-2021, aplikoni për 60 të drejta studimi

*Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit shtyhet deri më 28 gusht 2020*



punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi.

Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e FA-së (nga rradhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

#### Procedurat e aplikimit:

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në Aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e ushtarëve/detarëve apo nënoficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t’ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandimin për

pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

#### Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksi A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e

dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve; fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bangat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. b) Në përfundim të testimit; Kandidatët që janë kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda 5 ditëve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga përbarimi; raporti mjekësor i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor i Njësisë Mjekësore Ushtrake. Qendra e Personel Rekrutimit të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar “e-albania”, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit nga QPR-ja.

#### Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj në gjuhën anglisht do zhvillohet 01.09.2020, Testi Fizik do të zhvillohet në datë 02.09.2020, Testi Intelektual zhvillohet në datë 03.09.2020 kurse Testi Psikologjik do të zhvillohet në datë 04.09.2020.

Ish Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Lord Peter Peter Carrington

# Carrington ndihmoi në avancimin e një numri përparësish strategjike

*Ai e ka udhëhequr Aleancën përmes një kohe tensionesh transatlantike në vitet 1984 deri 1988, në vitet e fundit të Luftës së Ftohtë*

NGA RYAN C. HENDRICKSON

**L**ord Peter Peter Carrington ishte Sekretari i Përgjithshëm i gjashtë i NATO-s, që ka udhëhequr Aleancën përmes një kohe tensionesh transatlantike. Ai vdiq dy vjet më parë, më 9 korrik 2018. Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s ka qenë e mbushur me udhëheqës të talentuar dhe instrumentistë, të cilët kanë punuar për të avancuar konsensusin dhe bashkëpunimin midis aleatëve. Midis tyre është Lord Peter Carrington, i cili mbikëqyri Aleancën nga 1984 deri në 1988 në vitet e fundit të Luftës së Ftohtë. Megjithëse udhëheqja e Aleancës në një epokë të ndryshme me një sërë kufizimesh sistematike dhe institucionale, aftësitë dhe stili unik i Carrington ndihmuan në avancimin e NATO-s dhe unitetit transatlantik gjatë këtyre kohërave të trazuara.

Carrington mori detyrën në vitin 1984 me një dëshirë për t'i dhënë jetë dhe energjitë re NATO-s pas largimit të paraardhësit të tij. Sekretari i Përgjithshëm Joseph Luns, i cili kishte pasur postin në atë zyrë për 13 vitet e mëparshme, solli aftësitë e tij në zyrë, me një ndjenjë dhuntie dhe stil në udhëheqjen e Aleancës. Megjithatë, nga një raport gati universal, Luns mbeti në detyrë edhe para kryeministrit të tij, duke rezultuar në një Aleancë që "ishte në gjumë" - si për sa i përket politikës ashtu edhe ambicies institucionale. Misioni i NATO-s ishte akoma pothuajse ekskluzivisht i përqendruar në marrëdhëniet e saj me Bashkimin Sovjetik, i cili kufizoi shtrirjen dhe ambiciet e saj politike. Por, madje, në këtë kontekst, u kuptua që Aleancës i duheshin gravitacione dhe iniciativë e re.

Megjithëse të dhënat historike të NATO-s nën drejtimin e Luns dhe paraardhësit e tij ishin parë si një sukses nga shumë njerëz, Carrington u përpoq të sillte energji dhe respekt të ri për zyrën. Ai shpesh thoshte se "Ju nuk ndaloni së paguari sigurimin tuaj nga zjarri vetëm sepse kurrë nuk keni pasur zjarr". Kështu, Carrington besonte fuqimisht se NATO kishte nevojë për rëndësi të re dhe qëllimi i saj aktual dhe nevoja për të përgatitur NATO-n për gjeneratën e ardhshme mbetën po aq të rëndësishme sa kurrë.

Carrington nuk konsiderohej si një konceptualist, por më tepër si një udhëheqës politik pragmatik. Në këtë aftësi, ai ndihmoi në avancimin e një numri përparësish strategjike. Ndër hapat e tij të parë në detyrë dhe duke shkelur traditën e kaluar, Carrington iu afrua demokracive liberale të Evropës, duke arritur në Austri, Suedi dhe Zvicër, duke sinjalizuar interesin e Aleancës për t'u angazhuar me vendet që nuk ishin anëtare të NATO-s. Megjithëse ky ishte vetëm një hap i vogël dhe simbolik, Carrington ndihmoi në mbjelljen e farës për zhvillimin e dialogut dhe bashkëpunimit me jo anëtarët. Kjo së shpejti u realizua



pasi misioni i NATO-s u zgjerua në mënyrë të konsiderueshme me fillimin e operacioneve të menaxhimit të krizave në Ballkanin Perëndimor dhe aleatët krijuan korniza për bashkëpunim me vendet partnere në vitet 1990.

Një tjetër përparësi strategjike për Carrington ishte të bënte rastin për vendosjen e raketave të Shteteve të Bashkuara, Pershing II në Evropë. Ai besonte me ngulm se këto dislokime do të siguronin demonstrimin e nevojshëm të aftësive të Aleancës për të përparuar diplomacinë e NATO-s. Carrington u përball me publikun skeptik të Evropës në promovimin e kauzës, megjithëse ai kurrë nuk u tërhoq në diplomacinë e tij publike.

Përballë një presioni të jashtëzakonshëm nga Shtetet e Bashkuara, të udhëhequr kryesisht nga senatori i Shteteve të Bashkuara Sam Nunn, Carrington gjithashtu punoi me zell për të ndihmuar në rritjen e shpenzimeve evropiane të mbrojtjes. Ndarja e ngarkesave ka qenë prej kohësh një esencë e grindjes midis Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj. Por, në atë kohë, Carrington dhe Evropa u përballën me një sfidë të drejtpërdrejtë dhe kërcënim të hapur nga Senatori Nunn, i cili avancoi propozime gradualisht për të zvogëluar praninë e trupave amerikane në Evropë nëse Aleatët nuk i kushtonin më shumë mbrojtjes. Nunn kishte mbështetje dypartiake, kështu që veprimet e tij përfaqësonin një sfidë të vërtetë dhe të rëndësishme për praktikatat evropiane të shpenzimeve të mbrojtjes.

Ish-ambasadori amerikan David Abshire vëren se Carrington ishte thelbësor në adresimin e shqetësimeve mjaft të ngritura nga senatori Nunn dhe të tjerët. Ai mund të sillte një "prekje të

lehtë", që ishte efektive në menaxhimin e këtyre çështjeve të vështira transatlantike. Në këtë kontekst, ai ndihmoi në avancimin e çështjes, duke rezultuar në përmirësimin e mbrojtjes konvencionale për Evropën dhe zvogëlimin e sfidave diplomatike amerikane për Evropën.

Carrington gjithashtu ndihmoi në mbajtjen e anëtarësimit të ri të Spanjës në NATO (vendi ishte bashkuar më 30 maj 1982 megjithë kundërshtimin e konsiderueshëm të publikut), pasi qeveria e re e udhëhequr nga Felipe Gonzalez - e cila përfshiu Javier Solanan, i cili më vonë u bë Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s - ishin në atë kohë partnerë të pasigurt. Ashtu si pragmatist që ishte, Carrington udhëtoi në Spanjë në 1984, i përgatitur për të negociuar për çfarëdo lloj partneriteti, ushtarak ose politik, që qeveria mendonte se do t'i përshtatet më së miri interesit të vendit. Ai bashkëpunoi ngushtë me Komandantin e atëhershëm të Aleatëve të Evropës, Bernard Rogers për të krijuar një dialog diplomatik dhe ushtarak që u prit mirë nga Spanja, megjithëse nuk u bashkua me strukturën ushtarake të integruar të NATO-s deri në 1996.

Carrington u përball me tensione të tjera transatlantike gjatë mandatit të tij, të tilla si bombardimi i Libisë në 1986 dhe propozimet kryesore për kontrollin e armëve që ndodhën pa asnjë konsultim të NATO-s. Ai i drejtoi me sukses këto "kriza" dhe ndihmoi në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e kohezionit të Aleancës.

## Reformimi i NATO-s

Së bashku me sukseset e tij diplomatike, Carrington prezantoi një mori reformash brenda korridoreve të NATO-s

për të ndihmuar në rigjenerimin e organizatës. Një nga hapat e tij të parë ishte modernizimi i funksionimit të Zyrës Private të Sekretarit të Përgjithshëm dhe vendosja e procedurave për të ndihmuar në përmirësimin e efikasitetit. Ata që kanë punuar me të kanë vërejtur stafin e tij shumë kompetent dhe profesional. Ai gjithashtu priste që Asistent Sekretarët e Përgjithshëm të sillnin ekspertizën e politikave dhe propozime thelbësore në zyrën e tij.

Në lidhje me efikasitetin, një nga veprimet e para organizative të Carrington ishte të sigurohej që të gjitha takimet e Këshillit të Atlantikut të Veriut (NAC) - organi kryesor vendimmarrës politik brenda NATO-s - të fillonin me kohë, saktësisht në 10 të mëngjesit. Nëse ambasadorët nuk ishin të pranishëm, ai që më përpara e bëri të qartë, duke kërkuar që zyrtarë e rangut të dytë ose të tretë nga përfaqësimi kombëtar të ishin të pranishëm për të zënë karrigen e ambasadorit në tryezë. Carrington i shikonte veprimet e tij si një shfaqje e respektit për të pranishmit për të filluar me kohë, por gjithashtu nënvizoi se NATO kishte punë për të bërë. Për të siguruar që seancat e NAC të përparonin me sukses, si paraardhësit e tij, ai me mjeshtëri përdori dreka private informale të së martës me ambasadorët për të përcaktuar se cilat çështje mund dhe nuk mund të avancoheshin në seanca të hapura ditën tjetër.

Carrington gjithashtu gjatë periudhës më të madhe në postin e tij e përfaqësoi Aleancën në mënyrë më të mirë të mundshme, në mënyrë që aleatët si dhe audienca e tyre politike e brendshme të përgjigjen në mënyrë të favorshme për qël-

limin dhe misionin e NATO-s. Në kujtimet e tij, ai kujton se e ndjeu detyrë të shkëlqente në "fushën e komunikimit". Duke vepruar kështu, ai kërkoi shumë vende të ndryshme për të folur për misionin dhe qëllimin e NATO-s. Shfaqjet e tij të politeske dhe të gatshme në publik ishin rezultat i një përpjekjeje të konsiderueshme dhe përgatitjes paraprake. Me ndihmën e stafit të tij të Zyrës Private, përfshirë Zëvendës Drejtorin e tij Marc Grossman, Carrington do të përgatitej në mënyrë shteruese për ndërveprimet me shtypin, duke praktikuar për pyetjet e mundshme dhe sfidat publike që do të vinin.

Së bashku me gruan e tij, ai gjithashtu bëri përpjekje të mëdha për t'u shoqëruar dhe për të qenë i pranishëm gjatë mbrëmjeve, të cilat për ta ishte pothuajse çdo mbrëmje - të gjitha me qëllimin që të siguronin informata shtesë dhe të informonin më mirë të tjerët për qëllimin e NATO-s. Në mënyrë të ngjashme, Carrington vuri theks të madh në dy gjuhët zyrtare të NATO-s, Anglisht dhe Frengjisht, duke vërejtur sfidat që kjo mund të shkaktojë për aleatët e ndryshëm dhe duke siguruar që komunikimi të mbetet transparent dhe i hapur për të gjithë anëtarët.

Vetë Carrington shkruajti se si Sekretar i Përgjithshëm ai ndjeu "zhgënjim të pamohueshëm" duke pasur parasysh se udhëheqësi kryesor politik i NATO-s ka disa mjete zyrtare për të ushtruar pushtetin politik. Megjithatë, ai e mirëpriti dhe e vlerësoi në mënyrë të diskutueshme rolin e tij. Kolegët e tij kujtojnë gjallërisht profesionalizmin, sharmin dhe mirësinë e tij. Është e qartë se bashkëpunëtorët dhe kolegët e tij më të afërt e konsideruan atë si një lojtar të rëndësishëm në formimin e drejtimit të NATO-s në atë kohë. Pikëpamjet e tij u kërkuar për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve të vështira dhe të diskutueshme në kohën e krizës transatlantike, dhe përpjekjet e tij ishin të vlerësuara dhe me ndikim. Me fjalët e tij, Carrington drejtoi si "shërbëtor i një institucioni", i cili bën pjesë ngushtësisht me trashëgiminë e tij të udhëheqjes.

Ryan C. Hendrickson është Dekan dhe Profesor i Shkencave Politike në Universitetin Lindor të Illinois. Ai është autori i "Diplomacia dhe Luftës në NATO: Sekretari i Përgjithshëm dhe Veprimi Ushtarak pas Luftës së Ftohtë".



## FORCA TOKËSORE E NATO-S (LANDCOM)

# Gjenerallejtënant Cloutier mori detyrën nga Gjenerallejtënant Thomson

**G**jenerallejtënant Roger L. Cloutier Jr (Ushtria e Sh.B.A.) mori detyrën si Komandant i Forcave Tokësore Aleate (LANDCOM) nga Gjenerallejtënant J.T. Thomson (Ushtria e Sh.B.A.) në një ceremoni që u mbajt të martën 4 gusht 2020 në Izmir-Turqi, përpara udhëheqësve ushtarakë nga e gjithë Aleanca e NATO-s, ushtarë, diplomatë dhe anëtarë të shquar të komunitetit lokal. Gjenerali Tod D. Wolters (Forca Ajrore e Sh.B.A.), Komandanti Suprem i Aleatëve Evropë (SACEUR), kryesoi ceremoninë. Pjesëmarrësit e ceremonisë, stafi dhe të pranishmit ndoqen me nderime himnin e NATO-s dhe himnit kombëtar turk, gjatë ceremonisë së ndryshimit të komandës së komandës së NATO-s (LANDCOM) të mbajtur në 4 gusht 2020 në selinë LANDCOM në Izmir, Turqi.

Drejtuksi i ri i lartë, Gjenerallejtënant Roger L. Cloutier Jr, ka komanduar kohët e fundit Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara në Afrikë, Task Forcen në Evropës Jugore në Vincenza, Itali. Ai tha se përvojat e tij për të marrë rolin e tij të ri në NATO. “Në detyrën time të mëparshme u përqëndrova në ndërtimin e marrëdhënieve, gatishmërinë dhe ndërveprimin me ushtarët tanë, Aleatët Perëndimorë dhe partnerët përmes trainimeve komplekse dhe dinamike. Mezi pres të zbatohet mësimet që kam mësuar gjatë dy viteve të mia atje për të vazhduar punën e madhe që ka

*“Paqja, në vitin 2020, është vërtet e vështirë. Kemi shumë sfida sigurie në mjedisin e sigurisë. Kemi marrë COVID-19,” tha gjenerali Tod D. Wolters, Komandanti Suprem i Forcave Aleatëve në Evropë*



bërë kjo komandë nën udhëheqjen e J.T. Thomson”, tha Gjenerallejtënant Roger L. Cloutier Jr.

Në fjalimin e tij të lamtumirës, gjenerallejtënant Thomson, i cili del në pensionon pas më shumë 34

vjetësh shërbimi ushtarak, ofroi fjalë falënderimi për kombin pritës të LANDCOM-it, Republikën e Turqisë dhe popullin e Izmirit. “LANDCOM është shumë me fat që është i vendosur në këtë vend strat-

egjik në bregdetin e Egjeut. Ushtarët tanë, marinaret, avionët, marinsat, civilët dhe familjet nga 25 kombet janë përqafuar ngrohtësisht, dhe ne jemi jashtëzakonisht mirënjohës për mbështetjen e jashtëzakonshme dhe

të palëkundur,” tha Gjenerallejtënant Thomson. “Izmiri është vërtet shtëpi larg shtëpisë dhe kurrë nuk do ta harroj mirësinë dhe mikpritjen tënde të vërtetë”.

Gjenerali Tod D. Wolters, Komandanti Suprem i Aleatëve Evropë (SACEUR), zyrtarizoi ceremoninë midis dy oficerëve të lartë, të cilët të dy ai i konsideroi si “legjenda” të zanatit të tyre. Ndër lamtumirën e tij të përzemërt për gjenerallejtënant Thomson dhe mirëseardhjen e tij të përzemërt për gjenerallejtënant Cloutier ishte një shënim i fundit për burrat dhe gratë e LANDCOM. “Paqja, në vitin 2020, është vërtet e vështirë. Kemi shumë sfida sigurie në mjedisin e sigurisë. Kemi marrë COVID-19,” tha gjenerali Wolters. Në fjalën e tij përmbjllëse, gjenerallejtënant Thomson theksoi rëndësinë e LANDCOM për forcat tokësore të NATO-s. “Historia na mëson se forca e pengon agresionin,” tha ai. “Duke pasur parasysh kërcënimet e sotme në një epokë të konkurrencës së madhe të energjisë, është detyrë që forcat tokësore të jenë të gatshme dhe të forta.”

## EKSPERTI BELG TIM DE ZITTER

## Njeriu që punon në prokurimin shumëkombësh të municioneve



**T**im De Zitter është një menaxher i sistemit në Ministrinë Belge të Mbrojtjes. Ai punon me ekspertë me aleatët e tjerë të NATO-s për të blerë sisteme luftarake dhe sisteme raketash për t’u përdorur në fushën e betejës. “Projekti siguron që aleatët e NATO-s të ndajnë municione, dhe t’i blejnë dhe ruajnë së bashku në mënyrë që kështu të ulin kostot e përgjithshme duke përdorur shkallën e ekonomisë”, shpjegon ai. Ai gjithashtu mundëson që forcat aleate të veprojnë edhe më shumë së bashku. Themeluar nga Belgjika, dhe e udhëhequr nga Franca që nga janari i vitit 2020, kjo nismë shumëkombëshe e NATO-s njihet si projekti i Municioneve Vendimtare të Betejës Tokësore (LBDM). Aktualisht marrin pjesë 20 aleatë, Belgjika, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Franca, Gjermania, Italia, Letonia, Lituania, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia e Veriut, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar, si dhe vendet partnere Austria, Finlanda dhe Suedia.

### Projekte shumëkombëshe për të rritur aftësitë

Për të kryer misionet dhe detyrat e tyre, aleatëve të NATO-s i duhet të investojnë në pajisje të ndërveprueshme, të përparme dhe me kosto efektive. Për këtë qëllim, NATO mbështet aleatët në identi-

fikimin dhe zhvillimin e projekteve shumëkombëshe bashkëpunuese për të ofruar aftësitë kryesore të mbrojtjes të nevojshme. Nisma LBDM është një nga shembujt e shumtë të iniciativave për të promovuar një bashkëpunim më efektiv dhe të shpejtë shumëkombësh. Projektet e tjera përfshijnë fushat kryesore, siç janë strukturat stërvitore të pilotëve në mbështetje të Forcave të Operacioneve Speciale, blerjen dhe funksionimin e flotave shumëkombëshe të aeroplanëve për misione detare,

transportin e mallrave dhe furnizimit me karburante në ajër, ose futjen e sistemeve detare pa pilot.

“Projekti i Municioneve Vendimtare të Betejës së Tokës në NATO filloi në verën e vitit 2018 kur ministri i Mbrojtjes të NATO-s nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi dhe u deshën vetëm gjysmë viti më para që dërgesa e parë e municioneve të fituara shumëkombëshe kundërtank të dilnin nga kjo iniciativë”, vërejtje Tim.

Ndër opsionet e tjera, municionet


mund të blihen përmes Agjencisë së Mbështetjes dhe Prokurimit të NATO-s (NSPA) në emër të aleatëve dhe partnerëve të përfshirë në projekt. E vendosur në Luksemburg, NSPA është ofruesi kryesor i shërbimeve të NATO-s kur bëhet fjalë për blerjen e pajisjeve, duke ofruar një spektër të gjerë të aftësive të integruara për Aleancën, vendet anëtare dhe partnerët e saj. Aktualisht, Agjencia gjithashtu po luan një rol të rëndësishëm për t’u përgjigjur pandemisë në vazhdim COVID-19, duke ndihmuar aleatët dhe partnerët e NATO-s me blerjen dhe transportin kryesor të lehtësimeve.

### Sigurimi i efektit të dëshiruar në tokë

Tim De Zitter është një ish komandant toge, i cili gjithashtu ishte në Afganistan. Atij i pëlqen shumë puna e tanishme, veçanërisht diversiteti i aktivitetëve të tij. “Asnjë ditë e vetme nuk është e njëjtë. Një ditë flas me ushtarët në skuadër, ditën tjetër bëj një

projekt për simulim, një javë më pas jam jashtë vendit për një konferencë me përfaqësues nga kombe të ndryshme.” Motivimi i tij kryesor është sidonjë të sigurojë kënaqësinë e klientit, që në këtë rast do të thotë të sigurohet që ushtarët në këtë fushë të kenë qasje në aftësitë e sakta që u duhen. “Çdo gjë që ne bëjmë ka për qëllim t’i lejojë ata të bëjnë punën e tyre me mjetet më të mira dhe në rrethanat më të mira të mundshme.”

Municionet Vendimtare të Betejës së Tokës ndryshojnë në lloj, madhësi dhe peshë. “Nga granata, deri te predhat e tankeve dhe artilerisë e deri te raketat sipërfaqësore, ajo që pritet në fushën e betejës është efekti vendimtar: të neutralizojmë aftësinë e një kundërshtari të mundshëm, të krijojmë një ekran tymi në mënyrë që të mbrojmë vetë ushtarët dhe aftësitë tona ose për shembull për të ndriçuar mjedisin gjatë një operacioni natën”, thotë Tim. Familja e Tim është shumë krenare për të. “Për ta, më e rëndësishmja është që unë jam i lumtur me gjërat që bëj në punën time.” Në kohën e lirë, Tim pëlqen të punojë kopshtin e tij. “Qëna e perimeve dhe frutave në kopshtin tim shkon nga patatet, spinaqin, qepët dhe prasin, në të gjitha llojet e trangujve dhe kungujve. Sigurisht që prodhimi i shijshëm nga kopshti im ndahet me familjen dhe miqtë, ashtu si ne i bëjmë aleatët të ndajnë municionet e tyre së bashku.”



Procedurat e rekrutimit në FSK janë transparente të bazuara në parimin e meritokracisë dhe jo diskriminimit. Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për: hartimin dhe rishikimin e politikave për rekrutim në FSK; koordinimin e Planit për rekrutim me G1 SHPFK, para miratimit të Planit të rekrutimit nga KOMFSK dhe Ministri i Mbrojtjes, shpalljen e konkursit sipas Vendimit të Ministrit të Mbrojtjes...



## MINISTRIA E MBROJTJES E KOSOVËS

# Rregullore për rekrutimet në Forcën e Sigurisë së Kosovës

*Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për rekrutimin e pjesëtarëve aktiv, rezervë dhe kadetë të FSK-së*

**M**inistri i Ministrisë së Mbrojtjes, në pajtim me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, nenit 8, paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38, paragrafi 6 të Rregullores nr.09/2011 të Punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës, ka nxjerrë së fundi Rregullore për rekrutimet në Forcën e Sigurisë së Kosovës e cila ka si qëllim përcaktimin e autoriteteve, përgjegjësitë, kriteret dhe procedurat për rekrutim e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për rekrutimin e pjesëtarëve aktiv, rezervë dhe kadetë të FSK-së.

Procedurat e rekrutimit në FSK janë transparente të bazuara në parimin e meritokracisë dhe jo diskriminimit. Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për: hartimin dhe rishikimin e politikave për rekrutim në FSK; koordinimin e Planit për rekrutim me G1 SHPFK, para miratimit të Planit të rekrutimit nga KOMFSK dhe Ministri i Mbrojtjes, shpalljen e konkursit sipas Vendimit të Ministrit të Mbrojtjes; koordinimin e mbështetjes me specialistë për përgatitjen e testeve për rekrutim në FSK, sipas kërkesës së G1SHPFK-së; propozimin për iniciimin e procedurave për pastërtinë e figurës së kandidatëve brenda afatit 2 ditor pas marrjes së kërkesës nga G1 SHPFK, sipas dispozitave të rregullores përkatëse për pastërtinë e figurës.

Departamenti i Personelit në Shtabin e Përgjithshëm (G1SHPFK) është përgjegjës për: bashkëpunimin me Komandat e FSK-së për koordinimin e nevojave të rekrutimit; identifikimin e nevojave dhe hartimin e planit për rekrutim; zbatimin e procedurave të rekrutimit në FSK; shpërndarjen, pranimin dhe administrimin e dokumenteve të kandidatëve në fazën e konkurrimit, vendosjen e tyre në bazën e të dhënave dhe përgatitjen e raporteve; organizimin dhe realizimin e procesit të testeve; propozimin e caktimit të ekipeve testuese dhe intervistuese, të cilat me urdhëresë i miraton KOMFSK në fillim të çdo procesi të rekrutimit; shërben si sekretariat i Bordit Përzgjedhës; hartimin e Procedurave Standarde Operative për procesin e rekrutimit në harmoni me këtë rregullore; dërgimin e të dhënave së kandidatëve të përzgjedhur për trajnimin bazik në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes: jo më vonë se 10 ditë para se të fillojë trajnimi bazik për ushtarë dhe kadetë; jo më vonë se 60 ditë për oficer specialist; procedimin e të dhënave të kadetëve të përzgjedhur për studime në akademitë jashtë vendit së bashku me bazën e të dhënave të Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Afatet kohore përcaktohen nga DBNJ-ja dhe DBNIEA-ja në MM në bashkëpunim me shtetet partnere.

Bordi Përzgjedhës emërohet nga



Ministri i Mbrojtjes, përbëhet prej pesë (5) anëtarëve dhe udhëhiqet nga Kryesuesi i Bordit me gradën së paku Kolonel. Të drejtën e përzgjedhjes së Kryesuesit të Bordit dhe dy anëtarëve e ka Komandanti i FSK-së, të cilët ia propozon Ministrit. Dy anëtarët e tjerë janë zyrtarë/oficer nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, njëri nga Sektori i Rekrutimit dhe tjetri nga Departamenti për Menaxhimin e Karrierës dhe Verifikim. Në përbërjen e Bordit përzgjedhës për rekrutim në fushat specialiste së paku një anëtarë duhet jetë specialist nga

fusha e caktuar, ndërsa në përbërjen e Bordit për kadetë, njëri nga anëtarët duhet të jetë nga Qendra për Studime Universitare. Bordi i përzgjedhës në FSK emërohet në momentin e aprovimit përfundimtar të Planit të rekrutimit nga Ministri i Mbrojtjes dhe mandati i tij vlen deri në përfundimin e të gjitha fazave të rekrutimit brenda një cikli të rekrutimit.

Bordi përzgjedhës në FSK është përgjegjës për: miratimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kriteret për tu proceduar për teste dhe atyre të cilët nuk plotësojnë kriteret

sipas konkursit; miratimin e planit të testeve vec e vec për secilin test; miratimin e formateve dhe përmbajtjes së testeve.

Bordi Përzgjedhës pas çdo testimi mund ta ngritë ose zbret pragun e kalueshmërisë mbi minimumin e caktuar me këtë rregullore nëse në garë ka numër të vogël ose të madh të kandidatëve dhe nxjerrë listën e kandidatëve të cilat kanë plotësuar kriteret për kalimin në fazën tjetër të testimit, si dhe përcaktimin e pragut e kalueshmërisë për femra dhe minoritetet nëse është e nevojshme. Miraton listën finale të kandidatëve të përzgjedhur; mban procesverbal të vazhdueshëm në takime; organizon analizën pas veprimit pas procesit të rekrutimit.

### Kriteret e përgjithshme për rekrutim në FSK

Për t'u rekrutuar në Forcën e Sigurisë së Kosovës, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme: të jetë shtetas të Republikës së Kosovës; të kenë zotësi të plot për të vepruar; të kenë dëshmi për përfundimin e shkollës së mesme-kandidatët për rekrutë/

ushtarë; të kenë diplomë të shkollës së mesme – kandidatët për kadetë dhe testin e maturës; të kenë diplomë universitare - oficerët për kualifikime të veçanta specializimi; të ketë aftësi të nevojshme shëndetësore dhe fizike për vendin e shërbimit; të mos jenë të dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë; të kenë figurë të pastër dhe të mos kenë probleme dëbimi nga shtetet tjera. Moshë minimale për konkurrim në FSK është tetëmbëdhjetë (18) vjeç në datën e konkurrimit në FSK, ndërsa moshë maksimale si në vijim: tridhjetë vjeç (30) për oficer me kualifikime të veçanta specializimi; njëzet e një vjeç (21) për kadet; njëzet e tri vjeç (23) për ushtar. Kandidatëve iu kërkohet certifikata nga Gjykata dhe Policia e Kosovës për të kaluarën e tyre penale. Të mos kenë tatuazhe në fytyrë, qafë dhe parakrah nga pjesa e bicepsit e deri te gishtat e dorës duke përfshirë edhe presingun. Kandidatët që konkurrojnë për kadetë të FSK-së duhet të kenë njohuri të gjuhës angleze dhe të kenë notën mesatare gjatë shkollimit të mesëm "shumë mirë". Dhënia e informatave të rrejshme kurdo që zbulohet, gjatë procesit të rekrutimit apo gjatë shërbimit në FSK, rezulton me largim nga FSKja. Përgjithshme, kriteret e parapara me këtë nen, kandidatët që konkurrojnë për kadetë të FSK-së në qendrat/akademitë ushtarake të shteteve partnere duhet të plotësojnë edhe kriteret e shtetit pritës, në rast se kërkohet.

### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim në FSK

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për rekrutim në FSK duhet të plotësojnë formularin përkatës për konkurrim i bashkëngjitur në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje, deri në aplikimin e formularit online që do të dizajnohet dhe përdoret për proceset e rekrutimit. Formulari duhet t'i përmbajë edhe informatat për dokumentacionin që duhet t'i bashkëngjitet. Fazat e procesit të rekrutimit në FSK janë: fushata informuese dhe shpallja e konkursit; aplikimi; testimi; përzgjedhja; trajnimi bazik për rekrut, testi i karakterit për kadet; pastërtia e figurës. Procesi i testeve për ushtar përfshin: testin fizik; testin e inteligjencës; testi i njohurive të përgjithshme; intervistën; testin/ekzaminimin shëndetësor.

## QENDRA E MJEKËSISË E FSK-së


# Bashkëpunim me Shërbimin Spitalor dhe Klinikën Universitare

**D**rejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës, Dr. Valbon Krasniqi vizitoi Qendrën e Mjekësisë të FSK-së, ku u prit nga drejtori, Dr. Shkëlzen Sylaj. Takimi në mes të drejtorëve të dy institucioneve shëndetësore SHSKUK – QMFSK-së, u realizua me qëllim të thellimit të bashkëpunimit institucional. Drejtori i SHSKUK-së, Dr. Krasniqi, gjatë vizitës u njoftua nga drejtori i QMFSK-së, Dr. Sylaj, me kapacitetet në pajisje, personel dhe kapacitetet e shërbimit spitalor të Qendrës Mjekësore të FSK-së. Drejtorët Sylaj dhe Krasniqi biseduan edhe për gjendjen e përgjithshme të epidemisë COVID-19, si dhe për format e thellimit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve. Ndërsa, Dr.

Krasniqi, në fjalën e tij, tha se ndihet i privilegjuar dhe që ka emocione dhe ndjenjë të veçantë gjatë qëndrimit në Qendrën e Mjekësisë të FSK-së, duke shtuar se vizita në këtë qendër është frymëzim për vazhdim të punës si mjek, dhe njëherësh premtori që do të angazho-

het për zbatimin pikë për pikë të marrëveshjes në mes të dy institucioneve. Në takim u bisedua edhe për hapësirat dhe kapacitetet, që ka QMFSK-ja, dhe mundësinë e mbështetjes me staf mjekësor nga ana e Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar të Kosovës.





Përcaktimi i fortë i Maqedonisë së Veriut për financimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes u theksua edhe një herë, në përputhje me konkluzat e Samitit të Aleancës në Uells nga viti 2014. Megjithë sfidat e KOVID-19 me të cilat përballet Republika e Maqedonisë së Veriut, ende nuk ka devijime nga planet dhe prioritetet për arritjen e 2% të PBB-së deri në vitin 2024.



Bisedimet shumëpalëshe midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe NATO-s

# Mirëpritet angazhimi i armatës në operacionet ndërkombëtare

*Prezantohen planet për financimin, transformimin, dhe modernizimin e forcave të armatosura deri në vitin 2028*

**B**isedimet shumëpalëshe midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe NATO-s u mbajtën më 28 korrik 2020, përmes video telekonferencës. Këto janë bisedimet e para të këtij formati, që Maqedonia e Veriut mbajti si anëtare e plotë e Aleancës në kuadër të procesit të planifikimit të mbrojtjes të NATO-s. Delegacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut u drejtua nga sekretari shtetëror në Ministrinë e Mbrojtjes, Dragan Nikoliq.

Gjatë bisedimeve para Komitetit të NATO-s për planifikimin e mbrojtjes, u prezantuan planet për financimin e mbrojtjes, transformimin, pajisimin dhe modernizimin e forcave të armatosura deri në vitin 2028. Sekretari shtetëror Nikoliq theksoi se në kushtet e KOVID-19, Republika e Maqedonisë së Veriut mbetet e përkushtuar ndaj prioriteteve të përcaktuara për zhvillimin e kapaciteteve në përputhje me standardet e NATO-s.

Përcaktimi i fortë i Maqedonisë së Veriut për financimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes u theksua edhe një herë, në përputhje me konkluzat e Samitit të Aleancës në Uells nga viti 2014. Megjithë sfidat e KOVID-19 me të cilat përballet Republika e Maqedonisë së Veriut, ende nuk ka devijime nga planet dhe prioritetet për arritjen e 2% të PBB-së deri në vitin 2024.

Aleatët mirëpritën planet e mbrojtjes, si dhe angazhimin për përdorimin racional të burimeve për të pajisur forcat e deklaruara me pajisje moderne. Janë dhënë rekomandime për mirëmbajtjen e planeve për rritjen e buxhetit të mbrojtjes, si dhe për realizimin e prioriteteve për pajisjen dhe modernizimin e forcave të armatosura deri në vitin 2028. Gjithashtu u mirëprit edhe kontributi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në operacionet ndërkombëtare.



## Gjeneral Gjurcinovski në kazermat "Chede Filipovski" në Kërçovë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë maqedonase, gjenerallejtënant Vasko Gjurcinovski, si pjesë e përgjegjësisë së tij për turneun në njësitë e Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore, përpara se të kujtonte "Ditën e Ushtrisë" ka vizituar më 27 korrik 2020, kazermat "Chede Filipovski" në Kërçovë.

Gjatë turneut, gjeneral Gjurcinovski shprehu përkrahje dhe vlerësoi angazhimin e anëtarëve të ushtrisë maqedonase në mbështetje të institucioneve gjatë pandemisë së virusit "Covid 19", por edhe në vazhdimësi për të qenë sa më afër qytetarëve dhe institucioneve shtetërore sa herë që ata do të ketë nevojë.

Në këtë mënyrë, si një nga qëllimet e vizitës, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm perceptoi drejtpërdrejt funksionimin e njësisë dhe aktivitetet në këtë kazermë.



## MINISTRJA SHEKERINSKA

### Në Ditën e Republikës nën moton "Fitore për të gjithë"

Zëvendëskryeminstria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ministre e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska udhëhoqën një delegacion të qeverisë në Krushevë me rastin e Ditës së Republikës 2 gushtit, Ilinden, e cila këtë vit festohet nën moton "Fitore për të gjithë". Me rastin e festës kombëtare Ilinden, ministrja Shekerinska e shoqëruar nga ministri i Transportit dhe Lidhjeve Goran Sugareski vendosën kurora me lule në varrin e Nikolla Karevit në "Maqedonium", monumentin e heronjve në lokacionin Sliva dhe në monumentin për mbrojtësit e Republikës së Krushevës në Meçkin Kamen. "Me krenari u përkula në monumentet e Ilindenit në Krushevë në varrin e Nikolla Karevit në Maqedonium, monumentin e 40 heronjve dhe në Meçkin Kamen. Sot ne festojmë heronjtë e Ilindenit, që luftuan për liri dhe ata pas tyre që luftuan për shtetësi! Unë përkulem me krenari, sepse ne kemi përmbushur premtimin e brezit tonë një shtet i pavarur dhe i lirë, sot anëtar i NATO-s, i njohur dhe i barabartë me më të fuqishmit, në rrugën e sigurtë drejt anëtarësisë në BE. Ky është borxhi ynë ndaj paraardhësve tanë dhe ne nuk do të heqim dorë! Gëzuar Ditën e Republikës!" , -lexon urimi i ministres Shekerinska me rastin e Ditës së Republikës.




## FORCAT AJRORE

### Stërvitje me helikopterët Mi-24 nga Avioni WING

Si pjesë e aktiviteteve të planifikuara për trainimin e njësisë vartëse të Komandës së Operacioneve (CM), më 29 korrik 2020, në AP "Krivolak" avioni WING (VWING) realizon aktivitete stërvitore me një helikopter tip Mi-24 nga përbërja e VWING.

Aktiviteti i granatimeve helikopterë, raketave dhe bombardimeve (GRB) konsiston në të shtënat në shënjestra në tokë me një mitraloz helikopteri Mi-24, ku piloti përmes një procedure komplekse demonstroi trajnimin e tij në neutralizimin e caqeve tokësore në të gjitha kushtet e motit.

Në këtë aktivitet morën pjesë Komandanti i CM, Gjeneral Major Pavle Arsoški dhe Komandanti i VWING, kolonel Stojko Pejovski të cilët ndoqën të shtënat dhe manovrat e kryera me helikopterin Mi-24. Ky lloj i aktiviteteve të ushtrimeve është pjesë e trajnimit të rregullt të pilotëve në përputhje me planin e trajnimit në njësinë në të cilën duke kryer trajnime të vazhdueshme dhe pilot të trainimit nga VWING janë trajnuar për të kryer detyrat më të ndërlikuara, që dalin nga qëllimi i njësisë.



Ministri Karakachanov riafirmoi angazhimin e vendit Bullgarisë dhe deklaroi se Bullgaria i përmbahet rreptësisht parimit të “Pjesëmarrjes së përbashkët, rregullimit të përbashkët, tërheqjes së përbashkët”. Nga pala amerikane në takim morën pjesë gjithashtu Gjeneral Brigade Sean Sailin, Këshilltar Ushtarak i Përfaqësuesit Special, Z. Darrow Godeski Merton, Këshilltar i Lartë i Përfaqësuesit Special, si dhe përfaqësues të Ambasadës së SHBA në Bullgari.



KRASSIMIR KARAKACHANOV-ZALMAY KHALILZAD

# SHBA vlerëson kontributin e Bullgarisë në Afganistan

*Ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov u takua me Përfaqësuesin Special të Departamentit të Shtetit të SHBA-së për paqen në Afganistan, Zalmay Khalilzad*

Më, 30 korrik, Ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov zhvilloi një takim me Zalmay Khalilzad, Përfaqësuesi Special i Departamentit të Shteteve të Bashkuara për paqen në Afganistan. Në takim morën pjesë gjithashtu Heroi Mustafa, Ambasadori Fuqiptotë i Shteteve të Bashkuara në Republikën e Bullgarisë.

Tema kryesore e diskutimit ishte shkëmbimi i informacionit mbi të ardhmen e Afganistanit dhe përparimin e bërë në bisedimet e paqes midis qeverisë afgane dhe talebanëve.

Z. Khalilzad shprehu mirënjohjen e Shteteve të Bashkuara për pjesëmarrjen, kontributin dhe mbështetjen e Bullgarisë në Afganistan. Ai falënderoi në emër të Shteteve të Bashkuara, Forcat e Armatosura Bullgare për faktin se janë partnerë të Forcave të Armatosura të Shteteve të Bashkuara në kryerjen e kësaj detyre të vështirë. Z. Khalilzad informoi ministrin e Mbrojtjes në detaje për bisedimet të paqes midis qeverisë afgane dhe talebanëve.

Ministri Karakachanov riafirmoi angazhimin e vendit Bullgarisë dhe deklaroi se Bullgaria i përmbahet rreptësisht parimit të “Pjesëmarrjes së përbashkët, rregullimit të përbashkët, tërheqjes së përbashkët”.

Nga pala amerikane në takim morën pjesë gjithashtu Gjeneral Brigade Sean Sailin, Këshilltar Ushtarak i Përfaqë-




suesit Special, Z. Darrow Godeski Merton, Këshilltar i Lartë i Përfaqësuesit Special, si dhe përfaqësues të Ambasadës së SHBA në Bullgari.

Nga pala bullgare morën pjesë

gjithashtu nga Zëvendës ministri i Mbrojtjes Atanas Zapryanov, Gjenerallejtënant Dimitar Iliev, Zëvendës Shef i Mbrojtjes, si dhe ekspertë të Ministrisë së Mbrojtjes.

## Ka filluar trajnimi i zhytësve ushtarakë

Ka filluar takimi apo trajnimi i zhytësve ushtarakë për trajnimin nga inxhinierët e zhytjeve inxhinierike dhe të zbulimit të Forcave Tokësore. Takimi për trajnimin e zhytjeve ushtarake nga formacionet e zhytjeve inxhinierike dhe zbulimit të Forcave Tokësore u mbajt nga data 27 korrik deri më 7 gusht në formacionin ushtarak 54950-Burgas. U përfshinë ushtarakë nga Regjimenti i 55-të i Inxhinierëve-Belene, Brigada e 2-të e Mekanizuar-Stara Zagora dhe Brigada e 61-të e Mekanizuar-Karlovo. Gjatë orëve të mësimin, ushtarakët kanë kryer detyra për organizimin e zhytjeve në kushte të ndryshme, duke kaluar në thellësi të ndryshme, prejardhje praktike dhe ngjitje me pajisje zhytjeje ajri. Përgatitja përfshinte gjithashtu



zhytje, punë nënujore dhe inxhinierike, kërkimin e objekteve të mbytura dhe pajisjet e dëmtuara dhe kryerjen e ushtrimeve nënujore të sigurisë në prani të një instruktore zhytjeje. Kapiteni

Dimitar Marinov ishte përgjegjës për përgatitjen dhe zhvillimin e kampit të zhytjeve, kurse rreshteri i lartë Georgi Nachev nga Regjimenti i 55-të i Inxhinierëve-Belene ishte në zhytje.

Ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov

## Në aviacionin luftarak bullgar nuk ka pilot të zakonshëm

“Eshtë e lehtë në ditët e sotme të gesh një vend pune dhe një profesion diku larg Bullgarisë. Janë të paktë njerëzit që i përkushtohen profesionit më të vështirë, por edhe më fisnik dhe të përgjegjshëm-mbrojtës i atdheut”. Me këto fjalë ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov iu drejtua kadetëve në Shkollën e Lartë të Forcave Ajrore “G.Benkovski”, më 31 korrik 2020. Ai mori pjesë në aktin solemn të gradimit të oficerëve të diplomuar.

“Eshtë një nder i madh për mua që brenda një viti të kemi mundësinë të hapim Shkollën e Rivendosur të Forcave Ajrore dhe t’i paraqesim diplomat në klasën e parë. Bëhuni shembull dhe mbani mend një gjë: Në aviacionin luftarak Bullgar nuk ka pilot të zakonshëm. Ka oficerë bullgarë që i janë përkushtuar shërbimit të atdheut, mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të atdheut tonë Bullgarisë”, - tha ministri Karakachanov.


Ai i uroi maturantëve “fat të mirë” dhe prezantoi stemën e oficerit dhe diplomën e të diplomuarit i shkëlqyer, pilot Vladimir Taskov. Për suksesin e tij të shkëlqyer, Vladimir Taskov iu dha nga ministri Karakachanov, shpata e oficerit, një sasi të hollash dhe libra me tema historike.

“Ushtarakët me një shpirt të lartë, me ambicien për të patur arritjet me më të mirët në profesion, kanë qenë gjithmonë të arsimuar. Ata kanë shkruar dhe janë duke shkruar historinë e Forcave Ajrore. Ju do të plotësoni faqet e sotme dhe të së nesërme dhe nuk do të prishni traditën”, - theksoi Zëvendës Shefi i Mbrojtjes, gjenerallejtënant Dimitar Iliev.

Ai shprehu bindjen e tij se të diplomuarit do t’i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të përsosur dhe do të kontribuojnë në trajnimin efektiv luftarak të formacioneve të tyre. “Do të punoni në mënyrë aktive për të ruajtur dhe zhvilluar aftësitë operacionale të nevojshme për kryerjen e detyrave që ju janë caktuar në tre misionet e Forcave të Armatosura. Përfshirja e një niveli më të lartë të ndërveprimit me aleatët. Do të jeni komandantë dhe udhëheqës të suksesshëm”, - u shpreh Zëvendës Shefi i Mbrojtjes, gjenerallejtënant Dimitar Iliev.

Duke iu përgjigjur komentit të një gazetari në lidhje me shprehjet si “pilot i thjeshtë”, ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov tha: “Një pilot luftarak ka një avantazh të rëndësishëm, ai mbron vendin e tij. Dhe ai ka zgjedhur të punojë në këtë profesion të vështirë me një pagë më të ulët se në aviacionin civil. Ai nuk mund të jetë një pilot i thjeshtë, pavarësisht se kush është, qoftë ai që sapo është diplomuar, apo dikush që ka mbajtur një post më të lartë”.





Nënkoloneli Rakočević do të qëndrojë në mision për gjashtë muaj, ku do të kryejë detyra të stafit, nën komandën e operacionit në ujërat e Oqeanit Indian dhe në Gjirin e Adenit. Kryetari Dakiç uroi suksesin e saj dhe një det të qetë, me shpresën që ajo të përfaqësojë Malin e Zi në mënyrën më të mirë të mundshme.



MISION 6-TË MUJOR NË OQEANIN INDIAN

# Nënkolonel Rakočević dërgohet me mision në Gjirin e Adenit

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Malit të Zi, gjeneralmajor Dragutin Dakić, priti nënkolonelin e frigate Sara Rakočević me rastin e dërgimit në misionin detar "EU Navfor Atalanta" në anijen e komandës së forcës së TI Luigi RIZZO.

Nënkoloneli Rakočević do të qëndrojë në mision për gjashtë muaj, ku do të kryejë detyra të stafit, nën komandën e operacionit në ujërat e Oqeanit Indian dhe në

Gjirin e Adenit. Kryetari Dakiç uroi suksesin e saj dhe një det të qetë, me shpresën që ajo të përfaqësojë Malin e Zi në mënyrën më të mirë të mundshme.



TRE TE DREJTA STUDIMI

## Akademia në Ankara dhe Akademia Detare në Stamboll

**M**inistria e Mbrojtjes ka shpallur konkurs për zgjedhjen e kadetëve për Marsim në akademitë ushtarake në Republikën e Turqisë. Dy vende janë hapur në Akademinë e Ushtrisë në Ankara dhe një në Akademinë Ushtarake Detare në Stamboll. Për kandidatët që plotësojnë kriteret e kerkuara, Ministria e Mbrojtjes e Malit të Zi do të organizojë një test të shëndetit dhe fitnesit fizik, një test të gjuhës angleze dhe një kontroll sigurie. Pas përfundimit të arsimit, kadetët rekrutohen në Ushtrinë e Malit të Zi, pa shpallje publike, në gradën fillestare të oficerëve. Shpallja është e hapur deri më 13 gusht.



## Stafi mjekësor ushtarak, paga mujore është rritur në 300 euro

**M**inistria e Mbrojtjes ka përgatitur një dekret për ndryshimet në paga të personave që shërbejnë në Ushtrinë e Malit të Zi, i cili u miratua më 30 korrik nga qeveria. Sipas dokumentit, paga mujore e stafit mjekësor është rritur në 300 euro.

Duke marrë parasysh këtë rritje të pagave, si dhe faktin që Ministria e Mbrojtjes rregullisht i referon mjekëve nga Ushtria e Malit të Zi në specializim, është arritur qëllimi kryesor për të ndryshuar rregulloren aktuale, staf të plotë me staf cilësor të Qendrës Mjekësore Ushtarake, dhe në këtë mënyrë përmirësimin e niveleve të shërbimit, siguruar nga ajo qendër.

Zbatimi i rregullores do të fillojë në 1 shtator 2020, dhe fondet e nevojshme për zbatimin e tij deri në fund të vitit sigurohen nga buxheti. Ndërkohë ligji për mbrojtjen përcakton që Ministria e Mbrojtjes u siguron kujdes shëndetësor personave në shërbim të QKG-së dhe punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe ndryshimet në ligjin për kujdesin shëndetësor ofrojnë një mundësi që Ministria të sigurojë kujdes shëndetësor për anëtarët e familjes së tyre të ngushtë. Këta persona mund të marrin kujdes shëndetësor në Qendrën Mjekësore Ushtarake të QKG-së. Ministria e Mbrojtjes vazhdon të punojë dhe të kujdeset për punonjësit e saj, të kujdeset për ekzistencën e tyre, siç ka qenë deri më tani.



## “Guerile”, ose “luftë e vogël”

# Shtatë luftërat, ku forcat guerile mposhtën ushtritë profesionale

Ushtritë e mëdha profesionale, nuk i fitojnë gjithmonë luftërat ku angazhohen. Ndonjëherë ato që fitojnë janë njësitë luftarake të parregullta qofshin këto forca vullnetare, apo specialistë të trajnuar me taktikat jo konvencionale të luftës. Ata përballen me armikun përmes taktikave të ndryshme të mashtrimit, duke ia dalë të kenë avantazh ndaj një armiku shumë më të përgatitur, apo më të madh në numër.

### Spanja dhe lindja e guerileve

Termi “luftë guerile” vjen nga Lufta Gadishullore e viteve 1807-1814. Perandori francez, Napoleon Bonaoparti përdori një kombinim të manovrave politike dhe ushtarake, për të vënë nën kontroll Spanjën, dhe për të vendosur në fronin e saj mbretëror vëllain e tij. Po kjo gjë u kundërshtua nga shumë spanjollë, të cilët sulmuan forcat pushtuese, dhe i mbështetën britanikët kur ata nisën të përballen me Napoleonin në gadishullin Iberik. Sulmet nga njësitë guerile ishin shpesh brutale, ashtu siç ishin edhe hakmarrjet ndaj tyre, që përfshinin masakrat e shumta të kryera nga ushtarët francezë. Fjala “guerile”, që në spanjisht do të thotë “luftë e vogël”, hyri në gjuhën angleze përmes trupave britanike që e dëgjuan atë shpesh në gadishull.

### Revolucioni Haitian

Revolucioni Haitian i viteve 1791-1804 ishte unik në llojin e vet. Ai pati sukses dhe nuk u nxit nga shtresa e mesme, por përkundrazi ishte një rebelim i madh i skllevërve. Banorët e Santa Domingos i dëbuan kolonistët francezë. Njësitë e rebelëve përbëheshin nga skllevër të çliruar. Zemërimi i shkaktuar nga skllavëria, sollti akte brutale nga të dy palët. Numri i të vdekurve ishte i jashtëzakonshëm. Pasi i dëbuan padronët e tyre kolonialë, rebelët themeluan kombin e Haitit. Ajo ngjarje i tronditi fuqitë e mëdha të Europës.

### Të Njëmjittët në Itali

Fushatat e Xhuzepë Garibaldi për të bashkuar Italinë, u zhvilluan përmes forcave të parregullta ushtarake. Garibaldi ishte një nacionalist, që mbështetej tek vullnetarët atdhetarë, për të formuar ushtritë me të cilat realizoi revolucionin e shumëpritur. Ekspedita e Të Njëmjittëve në Sicili e vitit 1860 ishte më e shquara nga ato fushata. Duke qenë 25 herë më pak në numër se sa armiku, këmbësorët e Garibaldi arritën të mposhtin ushtritë profesionale të Mbretërisë së Napolit në një seri betejash të vogla. Duke



sulmuar gjithmonë të parët, trupat e Garibaldi ngjallën panik tek napolitanët. Kur kërkuan armëpushim, këta të fundit ishin sërish 5 herë më të shumtë në numër, megjithëse sicilianët kishin kaluar në anën e Garibaldi. Pasi vuri nën kontroll Sicilinë, Garibaldi u hodh në pjesën kontinentale të vendit. Ai e pushtoi Mbretërinë e Napolit, duke hyrë në qytet hipur në një tren me një pjesë të vogël të ushtarëve të tij. Ai ia kishte dalë të bashkonte pjesën më të madhe të Italisë.

### Lufta e Dytë Boere

Lufta e Dytë Boere e viteve 1899-1902, nuk sollti një fitore të trupave të parregullta, por ajo kujtohet ende si një triumf i taktikave guerile. Lufta nisi me sukseset e njëpasnjëshme të Boerëve, të cilat e tronditën Perandorinë Britanike. Britanikët u kundërpërgjigjën, duke dërguar në koloninë e Afrikës së Jugut një ushtri profesionale. Trupat britanike marshuan përtej Republikës së Transvalit dhe Shtetit të Lirë të Oranzhit, duke i detyruar boerët që të tërhiqen. Më pas këta të fundit, nisën të përdorin taktikat guerile. Pushkatarët boerë i

shkaktuan dëme të rënda britanikëve. Luftimet e vazhdueshme guerile, i detyruan britanikët të ndërtonin kampe përqendrimi dhe të rrethonin me tela me gjemba zona të mëdha nëpër shkretëtirë, për të kufizuar lëvizjen e boerëve. Edhe pse në fund britanikët fituan, ajo ishte një fitore e dhimbshme, dhe nga e cila mësuuan shumë gjëra se si nuk duhej luftuar.

### Afrika Lindore në Luftën e Parë Botërore

Britanikët u përballën me një situatë të ngjashme në Afrikën Lindore gjatë Luftës së Parë Botërore. Këtu, koloneli gjerman Paul Von Letov-Vorbek, e kuptoi se kishte shumë më pak trupa se armiku. Dhe në vend të një beteje frontale, ai e riorganizoi ushtrinë e tij duke përdorur pritat dhe sulmet guerile. Ai godiste dhe tërhiqej me shpejtësi. Britanikët i ndoqën gjermanët këmba-këmbës duke përfituar nga numri i madh i trupave në dispozicion, përfshirë trupat e Afrikës së Jugut që kishin luftuar më parë kundër tyre. Gjenerali britanik Jan Smats, një veteran boer, drejtoi fushatën më të suksesshme kundër tij,

duke përdorur manovrat dhe jo forcën brutale. Gjatë 4 viteve të luftës, britanikët nuk ishin në gjendje të kapnin Letov-Vorbek. Bastisjet dhe vjedhjet e furnizimeve nga ana e gjermanëve, ishin vazhdimisht problematike për ushtrinë britanike.

### Burma në Luftën e Dytë Botërore

Britanikët ndërruan rolet në Burma gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këtu, të nxitur nga sulmet e ushtrisë japoneze, ata adoptuan taktikat e luftës guerile. Ushtarakë të njohur si Hjujh Sigrim dhe të tjerë, rekrutuan rrjete luftëtarësh guerilë nga Birmania, që e kundërshtonin pushtimin japonez. Gjithashtu, britanikët trajnuar disa nga trupat e tyre për luftë guerile. Të udhëhequra me sukses nga Ordi Uingejt, këto forca u parashutuan prapa linjave të ushtrisë japoneze, për të sulmuar furnizimet dhe linjat e tyre të komunikimit. Uingejt zhvilloi një strategji të ndërtimit të bazave të vogla në xhunglën e kontrolluar nga Japonia, nga e cila mund të nisnin sulmet komando.

### Lufta e Vietnamit

Vietnami u prek rëndë në shekullin XX nga dy luftëra, në të cilat forcat e parregullta mposhtën ushtritë e huaja të pajisura me mjetet më moderne të kohës. Në fillim nisi Lufta e Indo-Kinës (1950-1954), në të cilën vietnamezët mposhtën ushtrinë koloniale franceze. Në betejën e Dien Bien Phu, vietnamezët përdorën biçikletat për të zhvendosur pajisjet dhe artilerinë e lehtë nëpër kodra. Në pamundësi për të përdorur tanket e tyre në një terren të dendur xhungle, dhe të shkëputur nga linjat e furnizimit, francezët u mundën. Pastaj erdhi Lufta e Vietnamit (1955-1975). Sërish, vietnamezo-veriorët u mbështetën tek taktikat e luftës guerile, duke i zënë prita vietnamezëve të jugut dhe aleatëve të tyre amerikanë. Kurthet, mashtrimet dhe rrjetet e gjera të tuneleve nëntokësore, luajtën një rol të madh në atë luftë. Megjithëse Amerika përdori në atë luftë të gjithë fuqinë e saj industriale atë të zjarrit, ajo nuk mundi t'i mposhte dot taktikat guerile, dhe manovrimin strategjik të gjeneralit vietnamezo-verior Xhap. / War History/



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

### Organizimi i rezistencës së armatosur

Një pjesë e territorit të qarkut të Dibrës ndodhej e pushtuar nga serbët prej vitit 1918, kur ushtria austro-hungareze u tërhoq me përfundimin e Luftës së Parë Botërore. Ushtria serbe përqipëj të mbante vijë kufiri "strategjik" pozicionet Qafat Llangë, Buall, Murrë dhe Lanën e Lurës. Ajo kishte kaluar kufirin e përcaktuar nga Konferenca e Londrës e vitit 1913 dhe mbante të pushtuar pjesën më të madhe të krahinës. Ushtria serbe në këto territore të pushtuara kishte përqëndruar forca në rajonet, Dibër e Poshtme 6 batalione, Gollbordë dy batalione dhe në Bulqizë një batalion. Komanda ushtarake serbe duke përfitur nga situata e vështirë politike e ushtarake në Shqipëri të përjetësionin pushtimin e krahinës së Dibrës në vijën e kufirit të pretenduar "strategjik" prej tyre. Në bashkëpunim dhe me forcat esadiste krijuan shqetësime për shtetin shqiptar në Dibër. Gjendja politike, ekonomike dhe ushtarake e krahinës paraqitej e ndërlikuar. Krahina ishte plaçkitur, djegur mjaft herë dhe pasuria e të gjithë fshatarëve ishte dëmtuar rëndë. Fshatarësia vuante nga dhuna e ushtuar prej serbëve dhe në masë ishte bërë çarmatosja e popullatës. Kudo në fshatra ishte ushtuar dhunë dhe kjo e shoqëruar me masakra të përgjakshme në fshatrat Kala e Dodës, Trebisht, Peladhi, Sopot, etj., ku ishin vranë mjaft fshatarë duke i shantazhuar për të dorëzuar armët. Kjo çarmatosje masive e popullatës rëndoi shumë në ekonominë fshatare, pasi pushtuesi i detyroi me forcë të punonin në ndërtime ushtarake, në transportin e municioneve etj. Forcat patriotike shqiptare e vlerësuan realisht qëndresën e popullit dibranë të pushtuar nga ushtria serbe dhe nisën përpjekje për luftë.

Qeveria e Sulejman Delvinës e vlerësoi rrezikun serb në Dibër, por në kushtet konkrete që po kalonte Shqipëria me Luftën e Vlorës dhe të Koplikut, nuk dëshironte një konflikt me shtetin serb. Shpresonte zgjidhje me ndërhyrje të diplomacisë europiane, por më parë të zgjidhej konflikti me Italinë. Në këtë kohë pozitat e shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare ishte ende e pa konsoliduar. Konflikti me serbët do kishte pasojat e dëmshme. Në këto kushte forcave patriotike dibrane ju shtrua si domosdoshmëri organizimi i rezistencës së armatosur. Veprimtaria luftarake kundër ushtrisë serbe ishte përqëndruar në fshatrat Arras, Vajkal dhe Steblevë. Ishte krijuar një vijë fronti në Dibrën e Poshtme duke filluar nga Ura e Dodës, Ura e Topojanit, gjatë lumit Drin i Zi, Bulqizë, Zall Murë dhe Kulla e Shabës, ndërsa nga Gollborda në Zall të Okshunit dhe në Shkallë të Borovës, pritej momenti i përshtatshëm për të kaluar në sulm. Qëndresa e popullatës kundër ushtrisë serbe nxitë lëvizjen patriotike në zonën e pushtuar, për të filluar përgatitjen për kryengritje. Ushtria serbe largohej nga territori shqiptar vetëm me luftë të armatosur, kështu mendonte lëvizja patriotike në Dibër. Ushtria serbe, në vijim bënte repr-ezalje për ta stepur lëvizjen patriotike dhe dobësuar qëndresën e armatosur. Nga fundi i majit 1920 ushtria serbe ndërmoi një repr-ezalje të përgjakshme në Kalanë e Dodës, krahinë luftarake duke vranë e therur mjaft fshatarë, deri gra, pleq e fëmijë, dogjiën shtëpi dhe grabitën bagëti. Këto vandalizma rritën zemërimin e popullsisë ndaj pushtuesit. Përpjekje me armë u shfaqën dhe në

# Në kuadrin e 100 vjetorit, lufta e Dibrës 1920



sektorin e Bulqizës, ku u organizua në çeta, në Vajkal me komandant Mehmet Duriçi, që ruante territorin dhe nuk lejonte ushtrinë serbe të shkelte vijën strategjike. Në zonën e Gollbordës e në Zabzum, ushtria serbe u shpartallua nga qëndresa e çetave.

### Forcat kryengritëse dhe komanda ushtarake

Jehonë në masat fshatare të Dibrës dhe në qarqet patriotike bëri fitorja e Luftës së Vlorës kundër italianëve. Patrioti Ismail Starzimiri ka shkruar se trimëria e pashembullt e treguar nga shqiptarët në luftën e përgjakshme që zhvillohej me ushtritë italiane dhe rezultatet e arritura prej tyre ngjallën një shpresë së madhe dhe një entuziazëm e guxim të papërshkruar, situatë besimin në forcat e masave popullore edhe të kësaj krahine. Patriotët dibranë në Tiranë të përfaqësuar nga deputeti Ramiz Daci dhe patrioti Ramiz Dibra, i kërkuan qeverisë së Sulejman Delvinës për të organizuar administratën e prefekturës në Dibër. Në fund të korrikut 1920 në fshatin Arras të Peshkopisë u vendos administrata e krahinës me prefekt Ramiz Dibrën. Administratë krijoi lidhje me krahinat e pushtuara dhe filloi përgatitjen për luftë të armatosur. Në "besën e përgjithshme" të krahinës vëmendja u drejtua për luftën kundër pushtuesit serb. Autoriteti i Prefekturës u rrit shumë. U krijuan dhe komanda ushtarake me komandant Elez Isufi. Komanda shqyroto dislokimin e forcave armike dhe çaktoi zonën e luftimit për çdo çetë. Ushtria serbë kishte kapur në pika dominuese në krahinë. Batalionet ushtarake serbe ishin të vendosur në Dibrën e Poshtme, shtabin kryesor e kishin ngritur në Kodrat e Llasenit, në jug të Peshkopisë. Forcat ushtarake i kishin përqëndruar në Majë të Llogorit, te Lisat e Tnenës, në Smollaviç, në Kodër të Bullgarit, në Qafë të Kërnelit, që të gjitha në territorin e fshatit Dohoshishtë. Në veri dhe në verilindja ishin vendosur në Gjarica të Brezhdanit, në Kodër të Kabe, në Pasma të Kishavecit, në Ostësh të Laçës, në Kodër të Kshtejës të katundit Kastriot, në Salbatër të Fushalës, në Shkeka të Shumbatit dhe në Kala të Dodës.

Forcat kryengritëse nga fshati Arras më 13 gusht 1920 i dërguan një ultimatum komandës ushtarake serbe ku i kërkohet që brenda 24 orëve të tërhiqeshin. Komanda ushtarake serbe nuk pranoi. Atëherë sipas planit luftarak të përpunuar më parë, u vendos të sulmohej ushtria serbe e përqëndruar në "Shkeka të Shumbatit" e pastaj në të gjithë gjithë krahinën. Sulmi do kryhej nga çetat e Ujës, Reçit e Dardhës nën komandën e Suf Xhelilit, nipit të Elez Isufit, të cilëve do t'u shkonin në ndihmë forcat e Arrasit. Pozicioni gjeografik i

Kodrinës së Shkekës paraqiste vështirësi të mëdha për ta sulmuar. Luftëtarët nga çdo anë që të ndërmerinin luftimin do gjendeshin të zbuluar dhe nën zjarrin e armëve serbe. Ushtria serbe ishte fortifikuar, kishte hapur transe dhe pajisjet luftarake ishin futur në tokë. Pozicionet kryesore ruheshin nga disa pozicione të përparura. Në këtë fortifikatë ushtria serbe kishte vendosur katër topa me rreze veprimi të gjatë. Marrja e këtij pozicioni ishte vendimtare për kryengritësit. Marrja e kësaj fortifikate u studiua dhe u përgatit me shumë kujdes. U vendos që së pari të goditeshin natën pikat e përparura, pa zhurmë dhe t'i afroreshin në fshehtëzi objektivit. Çeta e Ujës e komanduar nga Suf Xhelili kapi postën serbe në katundin Shumbat të sulmuar në befasi, duke dalë pa u diktuar në Shkeka, ndërsa çetat e Reçit dhe Dardhës asgjësuan postën në Zall Kalisit dhe dolën në Shkekë nga veriperëndimi.

### Sulmi i çetave "o besa besë"

Në mëngjes pa zbardhur drita nisi sulmi. Luftëtarët i mashtruan ushtarët serbë me sulme të rreme, me britma të fuqishme "o besa besë", iu afruan pozicioneve të fortifikuara. Zjarri i armëve të serbëve ishte shumë i dendur dhe terreni mjaft i disfavourshëm. Luftëtarët nuk e ndalën sulmin dhe u hodhën në llogoret armike. Pas sulmit në Shkeka filluan dhe sulmin çetat në Arras, Fshatarët e Çidhnës e një pjesë të Dardhës të komanduara nga Elez Isufi. Këto çeta kaluan lumin Drin të Zi nën goditjen e artilerisë serbe, ku përshkuan me shpejtësi Fushalien, ku u ndanë në dy grupe sulmuese. Grupi i parë sulmoi Salbatërën, poshtë Shkeka të Shumbatit. Grupi i dytë sulmoi në kah të Ostushit nga jugu. Grupi që sulmoi Salbatërën i detyroi forcat serbe të tërhiqen. Me tërhiqjen e forcave serbe çetat nisën përgatitjet për të sulmuar në Shkeka. Ushtria serbe në Shkeka të Shumbatit bëri një qëndresë, por sulmi i çetave të përqëndruara ishte tepër i shpejtë dhe masiv. Në llogore u bë luftim trup me trup. Ushtria serbe u largua në panik, ku la në fushën e betejës sipas të dhënave mbi 1.000 robë e të vranë. Në këtë betejë u shqua luftëtari Osman Tahir Paci, i cili ra dëshmor. Edhe sulmi i çetave të Muhërrit dhe të fshatrave të Kastriotit kundër Çapit të Brezhdanit dhe më tej edhe marrjen e Gjanicës nga luftëtarët. Forcat serbe gjatë kësaj kohe nuk u lanë të qetë dhe në prapavijet e tyre. Forcat serbe të përqëndruara në Kodër të Kabe, nga sulmet e vijueshme të çetave të zonës u detyruan të tërhiqen në drejtim të Zimurit, ku dhe u likuiduan plotësisht. Në pritën e organizuar nga këto çeta luftoi si një hero luftëtari Melaim Kulemam, ku dhe ra dëshmor. Edhe forcat serbe të përqëndruar në Kodër të Pollozhanit, u goditën nga çetat dhe u detyrua të ikin në

e kohës. Ushtria serbe ndeshi në qëndresën e luftëtarëve dhe sulmi nuk pati sukses për tri ditë me rradhë.

### Qëndresa e luftëtarëve dibranë

Luftëtarët dibranë të armatosur me pak fishekë, por të vendosur që ta mbronin me çdo kusht kufirin e atdheut, u bënë ballë heroikisht ushtrive të panumërta serbe. Në Skërtec, në Rabdisht, në Carakol, në porta të Korabit e në Gjegje të Bushtricsë ranë dëshmorë për mbrojtjen e kufirit me dhjetëra fshatarë të cilët luftuan me vendosmëri për mbrojtjen e tërësisë tokësore të shtetit shqiptar: si Halim Shaqir Leska, Naxhie Ali Murraku e Shaban Ali Dedanga katundi Ploshtan, Dali Ibrahim Koka nga Kalisi, Abaz Jakup Baloshi nga Radomira, Halil Bajram Hysenaj e Murat Bajram Hysenaj nga Kraj Reçi, Halil Zanel Doçi nga Kastrioti, Rushit Xhil Spata, Xhil Bajram Tota e Rexhep Sadik Tota nga Bllçe, Xhaferr Lokë Loka nga Sinja e Epërme, Allaman Ali Salkurti nga Rashnapoja, Lush Bunguri nga Grevja, Vahide Rushit Tola nga Çidhna, Zahide Tavanja nga Arrasi, Ismail Jashar Bodurri nga Okshatira, Sherif Ismail Bali nga Sohodolli, Abdulla Ibrahim Cara nga Bardhaj Reçi e sa e sa të tjerë. Luftëtarët dibranë pas një qëndrese të fortë, u tërhoqën drejt perëndimit, përtej Drinit të Zi. Popullata pjesërisht u tërhoq drejt Tiranës e drejt Matit, kurse një pjesë e konsiderueshme u strehua në shpellat e zonës së Çidhnës. Ushtritë serbe, pasi thyen përkohësisht rezistencën e fshatarëve, dogjiën gjithë krahinën dhe ndërmoren për hakmarrje, vrasje e masakra. Gjendja e Dibrës tërhoqi vëmendjen e krahinave të tjera të afërta. Elbasani u interesua dhe mbështeti fuqimisht qëndresën e krahinave kufitare të Gollbordës e të Bulqizës si duke i organizuar e armatosur emigrantët dibranë, ashtu edhe duke dërguar Forca të Armatosura në afërsi të vendeve ku bëheshin veprime luftarake.

Interes tregoi edhe krahina e Matit, meqë, pasi të përfundonte pushtimi i Dibrës, ushtritë serbe do të futeshin në zonën e tyre, prandaj shpejt vajtën në ndihmë dhe mbështetjen qëndresës në Vajkal e në Qafmurrë. Për lëvizjen patriotike të Dibrës u interesua veçanërisht "Komiteti i Kosovës", i cili përqipëj të bashkërendiste veprimtarinë ushtarake të të gjitha krahinave të pushtuara nga serbët. Kjo taktikë nuk gjeti aprovimin e qeverisë së Sulejman Delvinës, sepse ky nuk e shihte të përshtatshme organizimin e lëvizjes së armatosur. Pushtimi serb e vuri në gjendje të vështirë shtetin e ri shqiptar. Për ndaljen e ofensivës së tij u mobilizuan të gjitha krahinat e Shqipërisë së Veriut dhe me luftë të armatosur nga njëra anë e me anë bisedimesh nga ana tjetër u arrit që të dëbohej armiku nga zona e pushtuar. Qarqet shoviniste serbe u përpoqën t'i shfrytëzonin bisedimet për ta detyruar qeverinë shqiptare që të ndiqte një politikë projugosllave, nuk patën sukses. Qeveria e S. Delvinës iu drejtua me një notë Fuqive të Mëdha ku kërkonte tërheqjen e trupave të huaja nga toka shqiptare dhe të njëjhej tërësia tokësore e shtetit shqiptar.

Kryengritja e gusht-shtatorit e 1920-s e bërë nga populli i Dibrës kundër pushtuesit serb luajti një rol të rëndësishëm, ku u shua dhe u forcua edhe më shumë ndjenja e patriotizmit, spikati trimëria, guximi deri në vetëmohim dhe heroizmi masiv i luftëtarëve dibranë që në kushtet e pushtimit, pa marrë parasysh sakrificat në njerëz dhe në ekonomi, u përlëshën me një ushtri të rregullt, të armatosur më së miri dhe në numër shumë herë më të madh.



# FA në luftë kundër zjarreve në pyje dhe kullota

**S**ipas Qendrës Kombëtare të Operacionale dhe Mbrojtjes Civile, rreth 200 efektivë të Forcave të Armatosura janë angazhuar në keto ditë të nxehta të muajit gusht duke u ardhur në ndihmë forcave zjarrfikëse në disa bashki të vendit, ku janë evidentuar disa vatra zjarri. Kështu ato kanë qenë prezent në qarkun e Dibrës, në Lezhë-në njësinë administrative Shëngjin, zona Rëra e hedhur-Maja e Zezë, në malin e Karkarriqit, në Rubik, në fshatin Katund i Vjetër, në Elbasan, Gramsh në fshatin Siman, në Fier, në fshatin Hekal, Mallkastër, në njësinë administrative Terpan në pyllin e Ballollit në Berat, etj. Sipas kreut të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako, në total në gjithë Shqipërinë janë djegur 598 hektarë duke përfshirë dhe 2419 rrënjë ullishte dhe 217 rrënjë pemëtarie.

